



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 DHE ENERGJISË
 AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË
 DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
 DREJTORIA EMERGJENCAVE DHE SHPËTIMIT NË MINIERA

RREGULLORE

“PËR

**METODOLOGJINË E OFRIMIT TË SHËRBITIT “DËSHMI SHPËTUESI”, NGA
 AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA”**

1. **Baza ligjore** - Ligji nr. 135/2016 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtaritë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike”, neni 24, pika 1 dhe 2, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 341, datë 22.05.2019 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e emergjencave dhe shpëtitimit, si dhe procedurave të hartimit, përmbajtjes e miratimit të planit të emergjencës, të detyrueshme për subjektet që kryejnë punime nëntokësore dhe subjektet e tjera që kryejnë punime në nëntokë, në miniera apo në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjitike”.
2. **Objekti i kësaj rregullore** – Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i metodologjisë për ofrimin e shërbimit të “Dëshmi shpëtuesi” nga Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, kundrejt subjekteve shtetërore dhe private, vendase e të huaja, që kryejnë veprimtari minerare apo ndërtim të punimeve nëntokësore në veprat hidroenergjetike.
3. **Qëllimi i rregullores** – Qëllimi i kësaj rregullore është sigurimi i metodologjisë së të detajuar për ofrimin e shërbimit “Dëshmi shpëtuesi”, nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, për subjektet shtetërore dhe private, vendase e të huaja, që kryejnë veprimtari minerare apo ndërtim të punimeve nëntokësore në veprat hidroenergjetike.

4. Paraqitja e kërkesës nga subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare:

- Punonjësit e subjektit që kryen veprimtari për zhvillim të punimeve minerare në nëntokë e sipërfaqe apo ndërtojnë punime minerare nëntokësore në veprat hidroenergjetike, pajisen me leje (dëshmi) për ushtrimin e profesionit.
- Për t'u pajisur me leje (dëshmi), subjekti që kryen veprimtari për zhvillim të punimeve minerare në nëntokë e sipërfaqe apo ndërtojnë punime minerare nëntokësore në veprat hidroenergjetike, paraqet pranë institucionit kërkesën shkresore, me listen e dokumentacionit, të cilët do të testohen dhe më pas do të lëshohet leje (dëshmi shpëtuesi) për ushtrimin e profesionit.
- Pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera funksionon Komisioni teknik për lëshimin dhe pajisjen me leje (dëshmi shpëtuesi) të punonjësve të kërkuar nga subjektet si specialistë emergjence dhe shpëtimi për skuadrat e emergjencës e të shpëtimit të subjekteve. Ky komision ngrihet dhe funksionon me urdhër të titullarit të AKSEM-it;

5. Dokumentacioni shoqërues:

- Kërkesa nga subjektet që kryejnë veprimtari për zhvillim të punimeve minerare në nëntokë e sipërfaqe apo ndërtojnë punime minerare nëntokësore në veprat hidroenergjetike, duhet domosdoshmërisht të shoqërohet me dokumentacion që të quhet e vlefshme.
- Kërkesa duhet të jetë drejtuar Institucionit duke identifikuar shërbimin e kërkuar, të jetë e nënshkruar dhe e vulosur me vulën identifikuese të subjektit kërkuar.
- Në rast të kundërt, Institucioni kthen përkësën pas për plotësim të metash. Subjektit i lihet një afat për plotësimin e të metave të kërkesës.
- Dokumentacioni shoqërues duhet të jetë, si më poshtë:

Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
1	Kërkesë nga subjekti	Kërkuesi/ personi i autorizuar;	Po
2	Fotografi (2 copë)	Aplikanti	Po
3	Fotokopje ID (Letërnjoftim elektronik)	Aplikanti	Po
4	Kontratë e punës së personit që pajiset me dëshmi nga punëdhënësi	Aplikanti	Po
5	Raport mjeko- ligjor	Poliklinika Mjekësore	Po
6	Mandatpagesë	Banka	Po

6. Proçedura e testimit për lëshimin dhe pajisjen me leje (dëshmi shpëtuesi) të punonjësve të kërkuar nga subjektet si specialistë emergjence dhe shpëtimi për skuadrat e emergjencës e të shpëtimit të subjekteve:

- Pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera funksionon Komisioni teknik për lëshimin dhe pajisjen me leje (dëshmi shpëtuesi) të punonjësve të kërkuar nga subjektet si specialistë emergjence dhe shpëtimi për skuadrat e emergjencës e të shpëtimit të subjekteve. Ky komision ngrihet dhe funksionon me urdhër të titullarit të AKSEM-it;
- Komisioni mblidhet në bazë të kërkesave të dorëzuara në protokollin e institucionit.
- Të gjithë punonjësit e subjektit që kryen veprimtari specialistë emergjence dhe shpëtimi për skuadrat e emergjencës e të shpëtimit të subjekteve i nënshtrohen testimit për leje (dëshmi shpëtuesi).
- Pas përfundimit të testimit, komisioni vlerëson testimin dhe del me vendimin e kualifikimit.
- Afati i ofrimit të shërbimit është 10 (dhjetë) ditë nga data e dorëzimit të kërkesës në protokollin e institucionit.

7. Proçesi i njoftimit të dëshmisë së shpëtuesit:

- Me përfundimin e testimit nga Komisioni Komisioni teknik për lëshimin dhe pajisjen me leje (dëshmi shpëtuesi) të punonjësve të kërkuar nga subjektet si specialistë emergjence dhe shpëtimi për skuadrat e emergjencës e të shpëtimit të subjekteve, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera njofton subjektet minerare, për t'u paraqitur në një datë të caktuar për tërheqjen e lejes (dëshmi shpëtuesi).

8. Dëshmia e shpëtuesit përmban:

- Dëshmia e shpëtuesit përmban Institucionin që e ka lëshuar, të dhënat identifikuese të punonjësit (emër, atësi, mbiemër, NID), si dhe fotografinë e tij në format dokumentash.
- Në mes të dëshmisë së shpëtuesit shënohet *“I jepet e drejta të ushtrojë profesionin e SHPËTUESIT”, në bazë të proçesverbalit nr. _____, datë _____*
- Në krahun e majtë të dëshmisë është viti I lëshimit, periudha e testimit, kryerja e ekzaminimit mjekësor “I AFTË” në bazë të certifikatës mjekësore.
- Dëshmia e Shpëtuesit nënshkruhet dhe vuloset nga Kryetari i Komisionit të testimit.
- Dëshmia e shpëtuesit ka një afat vlefshmërie deri në 5 vjet.
- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera rezervon të drejtën e ndëshkimit të shpëtuesve sipas shkallës së fajësisë kur nuk zbaton rregullat dhe sigurinë në punë

9. Tarifa e shërbimit të ofruar:

- Tarifa për ofrimin e këtij shërbimi është 2000 lekë.
- Punonjësit e subjektit që kryen veprimtari për zhvillim të punimeve minerare në nëntokë e sipërfaqe apo ndërtojnë punime minerare nëntokësore në veprat hidroenergjetike pajisen me faturën e arkëtimit nga Institucionit, konkretisht Drejtoria Ekonomike, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit.
- Një kopje e mandate pagesës i bashkëlidhet kërkesës.

10. Dispozitat e fundit

- Kjo rregullore është e detyrueshme për zbatim nga Drejtoria Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera, Drejtoria Ekonomike, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit, dhe Komisioni teknik për lëshimin dhe pajisjen me leje (dëshmi shpëtuesi) të punonjësve të kërkuar nga subjektet si specialistë emergjence dhe shpëtimi për skuadrat e emergjencës e të shpëtimit të subjekteve.
- Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Titullar i Institucionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË
DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
DREJTORIA E INSPEKTIMIT

RREGULLORE

“PËR

**METODOLOGJINË E OFRIMIT TË SHËRBITIT “DËSHMI ZJARRMËTARI”, NGA
AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA”**

- 1. Baza ligjore** - Ligji nr. 135/2016 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtaritë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike”, neni 24, pika 1 dhe 2, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 214, datë 20.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 294, datë 10.05.2019
Për miratimin e rregullores për kërkesat e ruajtjes së sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve në miniera dhe punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike;
- 2. Objekti i kësaj rregullore** – Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i metodologjisë për ofrimin e shërbimit të “Dëshmi zjarrmëtar” nga Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, kundrejt subjekteve shtetërore dhe private, vendase e të huaja, që kryejnë veprimtari minerare apo ndërtim të punimeve nëntokësore në veprat hidroenergjetike.
- 3. Qëllimi i rregullores** – Qëllimi i kësaj rregullore është sigurimi i metodologjisë së të detajuar për ofrimin e shërbimit “Dëshmi zjarrmëtar”, nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, për subjektet shtetërore dhe private, vendase e të huaja, që kryejnë veprimtari minerare apo ndërtim të punimeve nëntokësore në veprat hidroenergjetike.
- 4. Paraqitja e kërkesës nga subjektet që udhetojnë veprimtari minerare:**

- Punonjësit e subjektit që kryen veprimtari për zhvillim të punimeve minerare në nëntokë e sipërfaqe apo ndërtojnë punime minerare nëntokësore në veprat hidroenergjetike, pajisen me leje (dëshmi) për ushtrimin e profesionit.
- Për t'u pajisur me leje (dëshmi), subjekti që kryen veprimtari për zhvillim të punimeve minerare në nëntokë e sipërfaqe apo ndërtojnë punime minerare nëntokësore në veprat hidroenergjetike, paraqet pranë institucionit kërkesën shkresore, me listen e dokumentacionit, të cilët do të testohen dhe më pads do të lëshohet leje (dëshmi) për ushtrimin e profesionit.
- Pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera funksionon Komisioni teknik për testimin dhe pajisjen me leje për përdorim civil të lëndëve plasëse (dëshmi zjarrmëtar) të personave fizikë, të kërkuar nga subjektet minerare dhe ato të inxhinierisë civile. Ky komision ngrihet dhe funksionon me urdhër të titullarit të AKSEM-it;

5. Dokumentacioni shoqërues:

- Kërkesa nga subjektet që kryejnë veprimtari për zhvillim të punimeve minerare në nëntokë e sipërfaqe apo ndërtojnë punime minerare nëntokësore në veprat hidroenergjetike, duhet domosdoshmërisht të shoqërohet me dokumentacion që të quhet e vlefshme.
- Kërkesa duhet të jetë drejtuar Institucionit duke identifikuar shërbimin e kërkuar, të jetë e nënshkruar dhe e vulosur me vulën identifikuese të subjektit kërkuar.
- Në rast të kundërt, Institucioni kthen përkesën pas për plotësim të metash. Subjektit i lihet një afat për plotësimin e të metave të kërkesës.
- Dokumentacioni shoqërues duhet të jetë, si më poshtë:

Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në protokoll nga aplikanti?
1	Vërtetim nga prokuroria	Ministria e Drejtësisë	Po
2	Dëshminë (librezën) e vjetër të zjarrmëtarit (n.q.se ka, nëse jo vërtetim arsimit ose kopje dëftese)	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera	Po
3	Dy fotografi 40X40	Aplikanti	Po
4	Fotokopje e ID (kartës së identitetit)	Aplikanti	Po
5	Kërkesë me shkrim drejtuar institucionit për zjarrmëtarin nga subjekti minerar/punëdhënësi	Aplikanti	Po

6	Kontratë punë e noterizuar midis punëmarrësit që kërkon të pajisjet me dëshmi zjarrmëtari dhe drejtuesit të subjektit (zotëruesi i lejes minerare)	Aplikanti + Noter	Po
7	Raport mjekësor bashkë me vizitat të mjeku kardiolog dhe neuropsikiatër	Poliklinika Mjekësore	Po
8	Vërtetim nga gjykata që nuk është në ndjekje penale	Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Po

6. Proçedura e testimit dhe pajisja me leje për përdorim civil të lëndëve plasëse (dëshmi zjarrmëtari) të personave fizikë:

- Pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera funksionon Komisioni teknik për testimin dhe pajisjen me leje për përdorim civil të lëndëve plasëse (dëshmi zjarrmëtari) të personave fizikë, të kërkuar nga subjektet minerare dhe ato të inxhinierisë civile. Ky komision ngrihet dhe funksionon me urdhër të titullarit të AKSEM-it;
- Komisioni mbledhet çdo të premte, duke mbledhur të gjitha kërkesat e dorëzuara gjatë javës.
- Të gjithë punonjësit e subjektit që kryen veprimtari për zhvillim të punimeve minerare në nëntokë e sipërfaqe apo ndërtojnë punime minerare nëntokësore në veprat hidroenergjetike I nënshtrohen testimit për leje për përdorimin civil të lëndëve plasëse (dëshmi zjarrmëtari).
- Pas përfundimit të testimit, komisioni vlerëson testimin dhe del me vendimin e kualifikimit.
- Afati i ofrimit të shërbimit është 14 (katërmëdhjetë) ditë nga data e dorëzimit të kërkesës në protokollin e institucionit.

7. Proçesi i njoftimit të dëshmisë së zjarrmëtarit:

- Me përfundimin e testimit nga Komisioni për testimin dhe pajisjen me leje për përdorim civil të lëndëve plasëse (dëshmi zjarrmëtari) të personave fizikë, të kërkuar nga subjektet minerare dhe ato të inxhinierisë civile, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera njofton subjektet minerare, për t'u paraqitur në një datë të caktuar për tërheqjen e lejes për përdorimin civil të lëndëve plasëse (dëshmi zjarrmëtari).

8. Dëshmia e zjarrmëtarit përmban:

- Dëshmia e zjarrmëtarit përmban Institucionin që e ka lëshuar, të dhënat identifikuese të punonjësit (emër, atësi, mbiemër, NID), si dhe fotografinë e tij në format dokumentash.
- Në mes të dëshmisë së zjarrmëtarit shënohet *“I jepet e drejta për transportin, ruajtjen dhe përdorimin dhe evidentimin e materialeve plasëse dhe shpërthyesë”, në bazë të proçesverbalit nr. _____, datë _____*”

- Në krahun e majtë të dëshmisë janë të detajuara 5 (pesë) rregulla për Dëshminë e Zjarrmëtarit.
- Dëshmia e Zjarrmëtarit nënshkruhet dhe vuloset nga Kryetari i Komisionit të testimit.
- Dëshmia e zjarrmëtarit ka një afat vlefshmërie deri në 5 vjet.
- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera rezervon të drejtën e ndëshkimit të zjarrmëtarëve sipas shkallës së fajësisë kur nuk zbaton rregullat në punë me materiale plasëse dhe shpërthyes.

9. Tarifa e shërbimit të ofruar:

- Tarifa për ofrimin e këtij shërbimi është 2000 lekë.
- Punonjësit e subjektit që kryen veprimtari për zhvillim të punimeve minerare në nëntokë e sipërfaqe apo ndërtojnë punime minerare nëntokësore në veprat hidroenergjetike pajisen me faturën e arkëtimit nga Institucionit, konkretisht Drejtoria Ekonomike, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit.
- Një kopje e mandate pagesës i bashkëlidhet kërkesës.

10. Dispozitat e fundit

- Kjo rregullore është e detyrueshme për zbatim nga Drejtoria e Inspektimit, Drejtoria Ekonomike, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit, dhe Komisioni teknik për testimin dhe pajisjen me leje për përdorim civil të lëndëve plasëse (dëshmi zjarrmëtar) të personave fizikë, të kërkuar nga subjektet minerare dhe ato të inxhinierisë civile.
- Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Titullar i Institucionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË
DHE EMERGJENCAT NË MINIERA

RREGULLORE E BRENDSHME

“Për

*procedurën e ofrimit të shërbimit online “Vërtetim regjistrimi” nga Autoriteti Kombëtar
për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera dhe për metodologjinë e monitorimit e të
kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”*

Në zbatim të ligjit nr. 107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on – line, nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, si dhe Urdhërit të Brendshëm nr. 545, datë 03.12.2024, nr. 2281prot “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores së brendshme për metodologjinë e ofrimit të shërbimit online “Vërtetim regjistrimi”, të Titullarit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera;

- ✓ me qëllim që të sigurohet ofrimi në mënyrë elektronike i shërbimeve të institucionit, si dhe ky shërbim të jetë sa më cilësor dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 61, të ligjit nr.107/2021 “Për bashkëqeverisjen” dhe të legjislacionit në fuqi;
- ✓ të rregullohet procedura e ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera duke lëshuar dokumentin përfundimtar elektronik, me nenshkrim ose vulë elektronike, në favor të subjektit kërkuar;
- ✓ procedurës dhe afateve të shkëmbimit të dokumentave ndërmjet institucioneve, nëpërmjet sistemit të qarkullimit të dokumentave me nenshkrimin elektronik, në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve deri në marrjen e shërbimit dhe të dokumentit elektronik me vulë elektronike ose nënshkrimin elektronik;
- ✓ metodologjisë së monitorimit dhe të kontrollit të veprimtarisë administrative, që kryhet në funksion të ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike;

Grupi i Punës, i ngritur me Urdhër të brendshëm nr. 545, datë 03.12.2024, nr. 2281 prot “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores së brendshme për metodologjinë e ofrimit të shërbimit online “Vërtetim regjistrimi”, harton këtë Rregullore të Brendshme e cila përcakton objektin e veprimtarisë së tij, si dhe vendosjen e disa rregullave të hollësishme të cilat duhet të ndiqen nga punonjësit, për procedurën e ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera duke lëshuar dokumentin përfundimtar elektronik, me nenshkrimin elektronik ose vulë elektronike, në favor të subjektit kërkuar.

Ndërveprimi i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat me subjektin kërkues, si dhe vendosja në dispozicion të tyre e dokumentit elektronik kryhet nëpërmjet platformës “e – Albania”. Institucioni është i detyruar t’ia vendosë shërbimin në dispozicion subjektit kërkues, në formën e dokumentit elektronik, me nënshkrimin elektronik ose me vulë elektronike, nëpërmjet platformës së sipërpërmendur.

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- **“Institucion”** është Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera.
- **“Shërbim on – line”** procesi që konsiston në vendosjen në dispozicion të informacion, lëshimin e aktit administrativ apo dokumenti zyrtar, ne favor të subjektit kërkues apo përfitues, në përputhje me Kodin e Proçedurave Administrative dhe që në kuadër të kësaj rregullore kryhet vetëm elektronikisht, sipas vendimit të këshillit të ministrave nr. 252, datë 29.04.2022.
- **“Platforma e-albania ose Portali Unik Qeveritar E – Albania”** ka të njëjtin kuptim si në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Portali Unik Qeveritar E – Albania” dhe miratimin e rregullave për mënyrën e funksionimit të pikës së vetme të kontaktit.
- **“Sistemi i qarkullimit të dokumentave me nënshkrimin elektronik”** në vijim i quajtur “SQDNE” është sistemi i cili bën të mundur komunikimin, shkëmbimin e dokumentave shoqëruese të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimit, aplikimi i të cilit realizohet nëpërmjet platformës “e – albania”, deri në lëvrimin e tij dhe lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik, si dhe monitorimin e lëvrimin të shërbimit sipas afateve ligjore.

PROÇEDURA E OFRIMIT TË SHËRBIMIT NË MËNYRË ELEKTRONIKE DHE TË SHKËMBIMIT TË DOKUMENTAVE NDËRMJET INSTITUCIONEVE

1. Ofrimi i shërbimit në mënyrë elektronike, pa shkëmbim dokumentacioni me institucionet e tjera.

- a. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera është i detyruar të administroj kërkesat për shërbim “Vërtetim regjistrimi” nëpërmjet platformës “E – Albania”.
- b. Në rast se pranë institucionit paraqitet kërkesa për shërbim me rrugë postare në formën e dokumentacionit shkresor apo nëpërmjet postës elektronike, atëherë institucioni nuk e realizon atë, por i kthen përgjigje kërkuesit brënda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, duke e udhëzuar ta paraqesë kërkesën nëpërmjet platformës “e – albania”.
- c. Përjashtimisht, vetëm dokumentat shoqëruese të kërkesës, të cilat nuk mund të ngarkohen në formatin elektronik, i dërgohen institucionit në format shkresor (hard copy). Në këto raste, kërkuesi paraqet kërkesën për shërbim nëpërmjet platformës “e-albania”, ndërsa dokumentacionin shoqërues të saj, origjinal ose të njëhsuar me të, e dorëzon në rrugë postare pranë institucionit.
- d. Afati i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera për realizimin e shërbimit, në kutipim të neneve 56 dhe 57 të Kodit të Proçedurave Administrative,

llogaritjet dhe fillon të ecë pas ditës kur kërkuesi ka paraqitur kërkesën në platformën “e – albania”.

- e. Afati i zbatueshëm për realizimin e shërbimit nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera është ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm që rregullon veprimtarinë e tij dhe procedurën administrative konkrete.
- f. Në mungesë të një afati të shprehur në legjislacionin e posaçëm, atëherë zbatohet sipas rastit, afatet e mëposhtme për realizimin e shërbimeve on – line:
 - **10 (dhjetë) ditë pune** nga paraqitja e kërkesës, në përputhje me pikën 1, të nenit 15, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kur shërbimi ka të bëjë vetëm me vendosjen në dispozicion të informacionit apo lëshimin e një dokumenti që realizohet apo hartohet pa nevojën e hetimit administrativ.
 - **10 (dhjetë) ditë kalendarike** nga paraqitja e kërkesës, në përputhje me pikën 5, të nenit 49, të Kodit të Proçedurave Administrative, kur shërbimi ka të bëjë me njesimin e dokumentave;
 - **60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike** nga paraqitja e kërkesës, në përputhje me pikën 2, të nenit 91, të Kodit të Proçedurave Administrative, kur shërbimi kërkon kryerjen e hetimit administrativ ose në rastet kur për kryerjen e shërbimit nevojitet prpoçedura vendimmarrje dhe miratimi nga komisione të posaçme.
- g. Shërbimi i vendoset në dispozicion kërkuesit, brënda afatit përkatës, në formën e dokumentit elektronik me nënshkrim ose vulë elektronike, duke ia përcjellë nëpërmjet platformës “e – albania”, në sesionin “hapësira ime”.

2. Ofrimi i shërbimit në mënyrë elektronike, kur nevojitet shkëmbimi i dokumentacionit me institucione te tjera

- a. Nëpunësi i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera është i detyruar që kërkesën për ndihmë administrative për kryerjen e një ose disa veprimeve të nevojshme, veçanërisht për njohjen me dokumente, fakte apo mjete të tjera të provës, në administrim të organit tjetër, sipas përcaktimit të nenit 71, të Kodit të Proçedurës Administrative, ta dërgojë jo më vonë se 1 (një) ditë pune nga paraqitja e kërkesës kërkuesit. Në çdo rast, ndihma administrative, sipas kësaj pike, kërkohet nëpërmjet SQDNE-së.
- b. Detyrimi i nëpunësit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, për mundësimin e dokumentave në SQDNE nis në momentin e marrjes së kërkesës për dokumentacion shoqërues nëpërmjet SQDNE-së.
- c. SQDNE – ja mundëson komunikimin për shkëmbimin e dokumentave shoqëruese të kërkuara ndërmjet institucioneve për ofrimin e shërbimit, aplikimi i të cilit realizohet nëpërmjet platformës “e – albania”, deri në lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik, si dhe monitorimin o frimit të shërbimit, sipas afateve ligjore.
- d. Shkëmbimi i dokumenteve dhe komunikimi ndërmjet institucioneve kryhet vetëm nëpërmjet SQDNE –së, në të cilën kanë akses punonjësit e administratës shtetërore, të caktuar për ndjekje të procesit.

- e. Në rastet kur nëpunësi i caktuar, për shkak të pamundësie apo të kryerjes së pushimeve vjetore të pagueshme apo pushimeve të tjera me ose pa pagesë, nuk është prezent në punë, institucioni duhet të marrë masa për personin zëvendësues, i cili akseson sistemin me kredencialet e tij, me qëllim respektimin e afateve të shërbimit.
- f. Aksesimi në sistem i punonjësit të administratës bëhet nëpërmjet kredencialeve personale, duke bërë të mundur identifikimin e tij në sistemin SQDNE, sipas legjislacionit që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.
- g. Dokumentet e hedhura në SQDNE nga punonjësi i administratës publike duhet të jenë të ngarkuara në këtë sistem sipas formatit të zyrtarizuar, të jenë të nënshkruara elektronikisht ose të pajisura me vulë elektronike, në varësi të dokumentit. Dokumentet, të cilat janë të ngarkuara në SQDNE dhe rezultojnë si të përfunduara, kanë vlerë të njëjtë me dokumentat e lëshuara në formën e shkresës fizike nga institucioni.
- h. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera që merr kërkesën për dokumentacion shoqërues nga institucionet kërkuese, kanë detyrimin t'u vendosin në dispozicion në SQDNE dokumentet shoqërues të kërkuara, brenda afatit të përcaktuar në ligjin përkatës ose, në mungesë të tij, brenda 2 (dy) ditëve pune nga e nesërmja e marrjes së kërkesës për dokumentet shoqëruese në sistem.
- i. Bëjnë përjashtim nga pika 19, e vendimit nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on – line, nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, rastet kur shërbimi i kërkuar nga kërkuesi duhet t'i mundësohet atij brenda 1 (një) ditë pune. Në varësi të këtyre shërbimeve, shkëmbimi i dokumentave ndërmjet institucioneve, nëpërmjet SQDNE - së duhet të kryhet brenda 1 (një) ditë pune nga e nesërmja e marrjes së kërkesës për dokumentat shoqëruese në sistem.
- j. Në rastet kur dokumentacioni shoqërues, i cili mundësohet apo gjenerohet nga institucioni, ka detyrim financiar, kërkesa konsiderohet e vlefshme vetëm pas pagesës së kryer on – line ose pas hedhjes në sistem të mandat pagesës së kryer. Në këto raste, afati i shkëmbimit të dokumentave shoqërues në sistem nis nga e nesërmja e momentit kur vlerësohet se detyrimi financiar është përcjellë në sistem.
- k. Për ndërveprimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera me kërkuesin dhe për realizimin përfundimtar të shërbimit në favor të kërkuesit, zbatohen të njëjtat rregulla si në pikat 6 deri në 11 të vendimit nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on – line, nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, duke vendosur në dispozicion të tij dokumentin përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrimin elektronik, nëpërmjet platformës “e – albania”.

MONITORIMI DHE KONTROLLI I ZBATIMIT, SHKELJET DHE PASOJAT

- a. Në mënyrë që të zbatohen afatet për shërbimin ndaj kërkuesit, nëpunësi, eprori apo titullari duhet të kenë mundësinë e monitorimit nëpërmjet sistemit për të verifikuar statusin e kërkesës. Çdo nëpunës përgjegjës duhet të vetdeklaroj, nëpërmjet sistemit, ofrimin e shërbimit ose statusin kërkesës, duke përfshirë edhe datën në të cilën është ofruar ky shërbim te qytetari ose subjekti që ka paraqitur kërkesën.

- b.** Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është institucioni përgjegjës për monitorimin e raportimin e zbatimit të afateve dhe përdorimit të SQDNE – së, në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve deri në ofrimin e shërbimit dhe dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik në platformën “e – Albania” sipas afateve ligjore.
- c.** Nëpunësit përgjegjës raportojnë pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje për vonesat, kerkesat e refuzuara apo gabimet gjate procesit për kërkim dokumentacioni, ofrimin e shërbimit dhe masat a marra nga institucioni ne rast vonese ne ofrimin e sherbimit.
- d.** Moskthimi brenda afatit te percaktuar në këtë rregullore dhe në Vendimin nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on – line, nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”i një dokumenti shoqërues nga institucioni përgjegjës nuk përbën pengesë për institucionin kërkues që të vijoj procedurat e mëtejshme të trajtimit të kërkesës.
- e.** Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore dhe në Vendimin nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on – line, nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre” përbën kundravajtje administrative dhe trajtohet sipas përcaktimeve të nenit 56, të Ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeversijes”, duke nisur procedurën e inspektimit. Në përfundim të inspektimit, në rast se konstatohen shkeljet e afateve dhe procedurave të përcaktuara në këtë vendim, ndaj punonjësit apo nëpunësit përgjegjës të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera dhe /ose Titullarit të institucionit merren masat e parashikuara në dispozitën e sipërpërmendur të ligjit nr. 107/2021.